



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Mars, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi - DSH Dr. Hajrullah Fejza, shef i Sektorit të shëndetësisë në DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes, ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit mars 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi gjithsej 269 lëndë, të cilat i përkasin trajtimeve mjekësore, ndërsa 42 prej këtyre kërkesave i përkasin kategorisë së ndryshme.

Stafi në këtë drejtori, kishte takime të përditshme me qytetarë për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i Planprokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Gjatë muajit mars 2021, u realizuan aktivitete të rëndësishme dhe përgjegjësi të planifikuara për periudhën raportuese:

- Identifikim dhe përgatitja e specifikave për procedurë prokurimin mars 2021;
- Përpilim i specifikave:
 - Furnizim me barna dhe material shpenzues;
- Njoftim elektronik për procedurë prokurimi;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik, stomatologjik dhe mjekësor;
 - Deratizimi i rrjetit të kanalizimit; bodrumeve dhe garazheve publike në komunën e Prishtinës;
- Përcaktim i stafit vlerësues;
 - Mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Monitorim dhe bashkëpunim me ekipin menaxhues rreth renovimit të objektit QMF 5 dhe QMF 4, e cila filloi në fillimin e muajit shkurt 2021;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Finalizimi i procedurave administrative (fatura, kërkesa) rreth aplikimit për marrje leje ndërtimi të QMF “Prishtina e Re”, zona Perëndim;
- Një nga prioritetet kyçe të kësaj periudhe ishin vizitat fizike informuese rreth identifikimit të nevojave të ndryshme në QMF dhe QMU;
- Në veçanti realizimi i aktivitetit “Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve KPSH”;
- Deri në ditën e raportimit u vizituan QMF 1, QMF 2, QMF 3, QMF 4, QMF 5, QMF 6, QMF 9, QMF 10, QMU, PKS, QMF “Mat” dhe QMF “Mati 1”;
- Lansohet projekti E – Shëndetësia;
- Koordinimi i aktiviteteve në mes të qendrës së vaksinimit dhe IKSHPK-së për fillimin e procesit të vaksinimit kundër virusit COVID-19;
- Asistencë gjatë përgatitjes së sallës “1 Tetori” për fillimin e vaksinimit kundër virusit COVID-19;
- Mbajtja e takimeve të përditshme me drejtorin e DSH-së, si dhe mbajtja e takimeve javore me drejtorin e QKMF-së dhe QMU-së;

- Vëzhgimi i punës në bazë ditore për ecurinë e dhënies së terapisë parenterale, si dhe testeve antigjene në QMF VII, në lagjen “Emshiri”;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Njoftimi i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së COVID-19;
- Përgatitje teknike rreth furnizimit dhe mbjelljes së luleve sezonale.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përgatitja e specifikave bazuar në planprokurimin 2021;
- Mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Fondi Burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. lëndëve
Pagat	7,570,000	2,226,627.15	554,049.16	
Mallra dhe shërbime				
10	1,294,300.00	647,150.02	91,213.47	82
21	400,000.00	44,927.50	39,557.72	35
Komunali				
	300,000.00	150,000.00	11,680.85	37
Kapitale	1,600,000	500,000.00		

21	1,600,000		46,529.26	1
22				
Subvencione				
	120,000.00	20,000.00	3,580.00	24
Gjithsej				179

Raport - deklarim të borxheve më të vjetra se 30 ditë;

Deklarimi për ATK-në;

Raportim mujor, shpenzimet e realizuara dhe për të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;

Raportimi i detyrimeve për përgatitjen e pasqyrave financiare;

Pranim te faturave dhe arkivimi i tyre;

Përgatitja e dokumenteve te nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;

Zotimi;

Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim të financave;

Përgatitja e deklaratave te disponueshmërisë për procedura të prokurimit

Më 18.03.2021, kemi mbajtur komision për shqyrtimin e kërkesave trajtim mjekësor;

* Shqyrtuar gjithsej - 195 kërkesa;

* Të miratuara - 190 kërkesa;

* Plotësim me dokumente shtesë - 5 kërkesa;

* Përgatitja e lëndëve për procedim të pagesave.

5.1.2. Takimet me palë;

Çdo ditë nga 9:00-15:00, DSH bën pranimin e palëve

5.1.3. Takimet me institucione tjera

- Drejtoria e investimeve kapitale;
 - o Menaxhim i kontratës – renovime dhe rindërtime;
- Drejtoria e Prokurimit;
 - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Urbanizmit;
 - o Kushte ndërtimore - Projekte arkitektonike QMF “Prishtina e Re” - zona Perëndim;

- Drejtoria e Parqeve:
 - o Furnizim me lule sezonale për objektet shëndetësore KPSH;

5.1.4. Diskutime publike, takime me qytetarë

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Drejtoria e Urbanizmit,
- Posta e Kosovës.

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjithsej 269 lëndë, të cilat i përkasin trajtimeve mjekësore, ndërsa 42 prej këtyre kërkesave i përkasin kategorisë “Të ndryshme”;

5.1.7. Përfitues të subvencioneve

5.1.8. Takime të tjera

Drejtori i Shëndetësisë, Dr. Bujar Gashi, gjatë këtij muaj, me qëllim të realizimit të objektivave të punës, ka pasur një serë takimesh të ndryshme, siç janë: takime me drejtorin e QKMF-së, me drejtorin e QMU- së. Në këto takime të ndara ka diskutuar për gjendjen e shëndetësisë primare në komunën e Prishtinës. Në këto takime drejtori Gashi ka biseduar edhe për vështirësitë që kanë QKMF-të dhe njësitë e sajë dhe QMU-së, sa i përket përballjes me situatën e krijuar më COVID-19, dhe gjetjen e alternativave për të përballuar sa më mirë këtë situatë nga stafi shëndetësor.

Një çështje me rëndësi sa i përket Sektorit të shëndetësisë në komunën e Prishtinës, ka të bëjë edhe me vaksinimin kundër virusit COVID-19, ku ka realizuar takime me grupe punuese së bashku me drejtuesit e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me ecurinë e këtij procesi të rëndësishëm.

Në kuadër të angazhimeve të tij të parreshtuara, drejtori i Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, ka qenë i ftuar në emisione të ndryshme televizive në vend, për të dhënë informacione të detajuara në lidhje me situatën me COVID-19 dhe për shëndetësinë në përgjithësi në kryeqytet.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;

- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUdhËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente – Prishtinë, gjatë muajit mars 2021 ka punuar, duke iu përshtatur situatës së pandemisë, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente për qytetarë e Prishtinës dhe fshatrave që i takojnë komunës, me ekipe mjekësore dhe autoambulanca.

Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të urgjencës, kanë dominuar rastet me:

- Gjendje febrile të dyshimta për COVID 19;
- Hipertension arterial;
- Bronchit acute;
- Sindroma acute coronare;
- Asthma bronchiale;
- Colicat abdominale;
- Gjendjet anxyozo depressive;
- Hipo dhe hiperglicemia;
- Carcinoma;
- Dhuna në familje;
- Aksidentet e trafikut;
- Lendimet.

SA i përket numrit të rasteve, një raport i detajuar është përpiluar nga zyrtarja e SISH-së.

Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVM)

Në kuadër të Edukimit të vazhdueshëm mjekësor, më 18 mars, është mbajtur ligjërata “On-line” nga Dr. Ekrem Maloku, neuropatolog në SHBA, me titull: “Prezantimet më të shpeshta të neoplazmat e trurit, tretmani dhe kujdesi në kushte paraspitalore.

Furnizimi me medikamente dhe material sanitar

Furnizimi vazhdon nga Ministria e Shëndetësisë - Divizioni Farmaceutik dhe nga kompanitë e kontraktuara nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Furnizimi me mjete mbrojtëse (veshje mbrojtëse, maska, doreza, kalaqe, syze) kundër COVID 19, janë plotësuar nevojat për stafin mjekësor.

Situata me pandeminë COVID 19.

QMU nëpërmes linjës tel. 194, vazhdon të ofrojë këshilla për qytetarë se si të mbrohen dhe si të veprojnë kur dyshojnë në infeksion me COVID 19.

Këshilla jep dispeçeri dhe mjekët e ndërrimit.

QMU gjatë kohës së pandemisë COVID-19, me përkushtim të gjithë stafit mjekësor dhe mbështetës, vazhdon të kryej detyrat dhe misionin e vet, duke iu ofruar ndihmë mjekësore urgjente të gjithë pacientëve në kushte të terrenit, në shtëpi, banesa, vende të punës, rrugë dhe çdo vend ku kërkohet, dhe sipas nevojës bën transportin nga shtëpitë ose banesat në klinikat e QKUK-së dhe anasjelltas.

Gjatë këtij muaj, nga kolektivi kemi pasur katër punëtorë të infektuar me COVID 19.

Gjendja e tyre paraqitet stabile, janë duke u trajtuar dhe qëndruar në izolim shtëpiak sipas rekomandimit të IKSHP-së dhe gjendja e tyre paraqitet stabile, pasi që jemi në kontakt të vazhdueshëm.

Si menaxhmentit me kërkesë të përgjegjësve të vaksinimit në QKMF-së, kemi përpiluar listën me të dhënat e punëtorëve për vaksinim kundër Pandemisë COVID-19.

Ndërsa me organizim të Federatës së Sindikatës së Shëndetësisë, deri tani një infermiere e QMU-së, më 20 shkurt është vaksinuar në Kukës të Shqipërisë.

Sipas informatave, transporti i punëtorëve shëndetësorë është bërë me autobusë me organizim të Federatës Sindikale të Shëndetësisë dhe pritet që vaksinimi të vazhdojë gjatë vikendeve të shtunave dhe të dielave, pa e penguar orarin e rregullt të punës në institucione shëndetësore.

Nga aktivitetet kulturo- sportive

Ekipe mjekësore të QMU-së kanë asistuar dhe mbështetur turnirin “Adem Jashari”.

Turniri është mbajtur me organizimin e Federatës së Futsallit në përkujtim dhe nderim të Epopesë së komandantit Adem Jashari.

Turniri është mbajtur sipas këtyre termineve në Pallatin e Rinisë.

Dita 04.03.2021 nga (15:30 deri 19:30)

Dita 05.03.2021 nga (17:30 deri 19:30)

Gjithsej 6-orë asistencë mjekësore. Gjatë ndeshjeve nuk ka pasur lëndime serioze.

Më 23.03.2021 prej orës 17:30 deri në orën 21:30, gjithsej 4 orë. Dy ekipe mjekësore me auto ambulancë kanë asistuar në stërvitjet e Kombëtares së Futbollit të Kosovës dhe Lituanisë.

Ndërsa ndeshja miqësore mes reprezentacionit të Kosovës dhe Lituanisë, është luajtur më 24.03.2021. Me këtë rast, dy ekipe mjekësore kanë asistuar me autoambulanca, nga ora 17:00 deri më 23:00, gjithsej 6 orë. I gjithë aktiviteti, stërvitja dhe loja është mbajtur në stadiumin “Fadil Vokrri”.

Më 27.03.2021 nga ora 17:30 deri në orën 21:30, gjithsej 4 orë, dy ekipe mjekësore kanë asistuar në stërvitjen e reprezentacionit të Kosovës dhe Suedisë.

Ndërsa ndeshja zyrtare në kuadër të kualifikimit për kampionatin botëror me organizim të FIFA-s, mes Kombëtares së Kosovës dhe Suedisë është luajtur më 28.03.2021, prej orës 17:00 deri 23:00.

Në këtë ndeshje u asistua me dy ekipe dhe autoambulanca kemi nevojë për ekipe me auto ambulance, gjithsej 6 orë. Stërvitja dhe ndeshja janë zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”.

Këto kanë qenë angazhimet dhe aktivitetet kryesore të QMU-së, gjatë muajit mars, 2021.

Raporti i përmblodhur për muajin mars i koordinatores së SISH -it në QMU

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1312
2	Vizita mjekësore në QMU	9
3	Aksidentet trafiku	63
4	Fatkeqësitë në punë	3
5	Fatkeqësitë e tjera	52
6	EKG	22
7	Konstatim vdekjeje	54
Gjithsej		1515

ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese.
- Bashkëpunimi i zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në komunë dhe bashkëpunimi sipas UA/2016 të LPP me AQP për kyçe në kontratat e centralizuara.
- Sipas LPB, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranim të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj. sipas nevojave të paraqitura.

❖ AKTIVITETET E ZBATUARA

- Bashkëpunimi me AQP për kontratën e centralizuar, furnizim me material shpenzues zyrtar-nivel lokal-Loti VI, me nr. AQP 19 008 111, e datës 10.06.2020, caktimi i menaxherit të kontratë si dhe PMK.
- Nxjerrja e urdhërblereve në sistemin e FREE BALANCIT për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU.

❖ AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR

- Pranimi i kërkesës për furnizim me regjenca dhe material tjetër shpenzues për furnizim me një procedurë minimale, në pritje për zotim të mjeteve për me filluar me procedurë të prokurimit.
- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës .

ZYRA E FINANCAVE NË QMU

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës për raportin financiar të shpenzimeve dhe të hyrave për TM/I-2021;

- Sistemimi i lëndëve sipas aktiviteteve, furnizime, shërbime, duhet të kryhet për çdo muaj.
- Të kryhen raporte financiare çdo tre muaj, në mënyrë që të përcillet gjendja e pagesave në afat të duhur.

❖ **AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA**

- Përgatitja e lëndëve të poshtëshënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre;
- Mbushje telefonike për punëtorë, shuma 299.37;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira 347.00, janar;
- Furnizim me karburante 1,281.53, muaji shkurt;
- Përgatitja e 4 faturave për mirëmbajtjen e aparaturë mjekësore, shuma 2,370.00;
- Shtesat e pakos emergjente, mars, 16,550.00;
- Ndërrimet e natës për mars, 11,354.52;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna, korrigjime të vjetëve të punës etj., për muajin mars;
- Përgatitja e pagave për 6 punëtorë me kontrata për punë specifike, për muajin mars, shuma - 2,407.64.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPËR**

- Faturat të cilat duhet te përgatiten për pagesë, të cilat kanë arritur në Zyrën e financave pas datës 6 mars;
- Fatura e ngrohjes, mars, shuma 1,698.92;
- Përgatitja e ndërrimeve për muajin prill, pasi të vjen lista nga kryeinfermieri;
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë, ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta, së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera;
- Përgatitja e raportit TM /I, deri më 15 prill;
- Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imët etj.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:

- Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V), kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 - 13:30; 13:30 - 20:00 dhe 19:00 - 07:00);
- Katër qendrave të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) edhe gjatë marsit kanë punuar me orar të punës prej: 07:00 - 20:00, dhe kujdestari fundjave: 07:00 - 19:00 të shtunave dhe 07:00 - 13:00 të dielave;

- Në qendrat tjera (QMF 1, 3, 8, 9, 10, 11, Mat dhe Mat 1) është rikthyer orari i mëhershëm i punës në dy ndërrime (07:00 – 13:30 dhe 13:30 – 20:00);
- Me orar 07:00 – 14:00, janë kthyer në punë edhe AMF Barilevë dhe AMF Llukar, krahas ambulancave të rifunksionalizuara më herët (AMF Bardhosh, AMF Mramor, AMF Shkabaj dhe AMF Keqekollë).
- Numri i stafit të të infektuar deri më 31 mars 2021, ka arritur shifrën prej 424 personave, me së paku dy veta që për herë të dytë janë konfirmuar pozitiv;
 - QMF 7 “Emshir” ka vazhduar të shërbejë si qendër për administrimin e terapisë parenterale për qytetarët e Prishtinës të infektuar me COVID 19, edhe gjatë muajit dhjetor, në dy ndërrime 8 orëshe: 8:00 – 16:00 dhe 16:00 – 24:00. Gjatë muajit mars 2021, janë administruar plot 10566 infuzione intravenoze. Prandaj, puna në QMF 7 ka vazhduar me resurset humane të janarit;
 - Ndërkohë në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigenik për qytetarët e Prishtinës, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit, që të dyja këto falas.

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe Shërbimi stomatologjik ka vazhduar punën në të gjitha QMF-të me orar të rregullt dhe ka kthyer të gjitha shërbimet e veta në funksion.

Viz. mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
93829	102567	78514	13997	3059	291966

REKOMANDIM

Trendi në rritje i numrit të pacientëve që kërkojnë trajtim parenteral në QMF 7 “Emshir” për COVID 19, na imponon dhënien e terapisë parenterale nëpër qendrat tjera, aty ku hapësirat janë të përshtatshme për kryerjen e këtij shërbimi.